

**UDHËZIM**  
**Nr. 4, datë 28.2.2006**

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË VLERËSIMIT DHE AKREDITIMIT PËR SHKOLLAT E LARTA JOPUBLIKE**

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës, nenet 10 dhe 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), në pikën 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.303, datë 1.7.1999 “Për krijimin e Sistemit të Akreditimit në Arsimin e Lartë”, i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.611, datë 4.12.2002 “Për një ndryshim në vendimin nr.303, datë 1.07.1999, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Sistemit të Akreditimit në Arsimin e Lartë”, në pikën 3/b të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.156, datë 22.3.2001 “Për shkollat e larta jopublike në Republikën e Shqipërisë dhe në pikën 1/c të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.424, datë 9.07.1998 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”

**UDHËZOJ:**

1. Tarifa për vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin e shkollave të larta jopublike të jenë si më poshtë:
  - a) Tarifa bazë për vlerësimin dhe akreditimin akademik dhe institucional për çdo program, kurs studimi apo njësi të arsimit të lartë që vlerësohet në mënyrë individuale të jetë 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë.
  - b) Tarifa për vlerësimin dhe akreditimin e njëkohshëm të dy ose më shumë programeve/diplomave/njësive të arsimit të lartë me trung të përbashkët të shtohet me 25% të tarifës bazë për çdo program/diplomë shtesë.
  - c) Në rastet kur kërkohet pjesëmarrja e një eksperti të huaj në vlerësim, pagesa e tij llogaritet mbi tarifën e parashikuar në pikën 1/a dhe 1/b, dhe përballohet nga shkolla e lartë jopublike që ka kërkuar vlerësimin.
2. Tarifa për çdo vlerësim, e llogaritur sipas pikave 1/a dhe 1/b të këtij udhëzimi, arkëtohet paraprakisht, në llogarinë buxhetore të Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë.  
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE I SHKENCËS**  
**Genc Pollo**